



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 1 , Datë 20.02. 2015

Për

Miratimin e projekt-zbatimit për ndërtimin e veprës “ Diga Ura e Fangut”.

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe neni 9, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 12.02.2015, mori në shqyrtim projekt-zbatimin për ndërtimin e veprës “ Diga Ura e Fangut”, e hartuar nga kompania “Ayen As Energji ”

Prezantimi i projekt-zbatimit u bë nga përfaqësuesit e kompanisë “Ayen As Energji” në mbledhjes e datës 12.02.2015.

Mbas diskutimeve sqarimeve nëpërmjet përfaqësuesve të kompanisë dhe anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, si dhe në vijim të vendimit nr.1, datë 18.04.2014 projekt-idesë për “Digën e HEC-it të Fangut mbi lumin Fan”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha:

VENDOSI

Të miratoj projekt-zbatimin e Digës HEC-it Ura e Fangut, me lartësi maksimsle 92 m,

- | | |
|-----------------------------|---------------------------|
| • Kuotë e kreshtës së digës | 169.00 m (kuotë absolute) |
| • Kuota e parapetit betonit | 171.00 m (kuotë absolute) |
| • Niveli minimal i ujit | 138.00 m (kuotë absolute) |
| • Niveli normal i ujit | 165.00 m (kuotë absolute) |
| • Niveli maksimal i ujit | 167.88 m (kuotë absolute) |

- Prurje shkarkimi HQ 1,000 = 1,186 m³/sek.
- Prurje shkarkimi HQ 10,000 = 1,478 m³/sek.

Ky miratim shoqërohet me zbatimin e detyrave të mëposhtëme:

1. Brënda muajit Maj 2015 të paraqitet për miratim në KKDM, nga projektuesit En-Su Muhendislik ve Musavirlik, një material suplementar me argumenta të plota dhe saktësimet për analizat sizmike dhe efektet përkatëse në gjëndjen e sforcuar dhe deformimet e digës të cilat të mbështesin plotësisht sigurinë e digës, duke patur për bazë:
 - vlerësimin e rrishtit sizmik sipas studimit nga firma Geo Seis- IT Consulenting;
 - kushtet teknike në fuqi në vëndin tonë mbi projektimin antisizmik të digave
 - rekomandimet përkatëse të ICOLD-it, si dhe sugjerimet e vecanta (shih bashkëlidhur) “Vlerësime mbi trajtimin e aspekteve sizmike në projektimin e digës së HEC-it të Fanit” që u paraqitën për këtë aspekt në mbledhjen e KKDM-së, datë 12.02.2015.
2. Mbështetur në nenin 9, pika 1,3,7 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, të bëhet kontrolli i të dhënave të projektit me rezultatet faktike të zbatuara në objekt, lidhur me treguesit e mbushjes me gurë si për ato të llogaritjes së qëndrueshmërisë deformimit e granolometrinë e materialeve mbushëse .
Këto rezultate të paraqiten në KKDM, mbas shtresave të para të mbushjes së digës (brënda muajit Maj 2015).
3. Në zbatim të nenit 20 të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, të dërgohen për miratim në KKDM mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij. Kjo është një detyrë e domosdoshme për zbatimin e kuadrit ligjor të objektit në Republikën e Shqipërisë.

Është detyrë e konçensionarit “Ayen As Energji” të respektojë zbatimin e detyrave të mësipërme.

Me respekt,

Inxh. Maksim Muçi

K R Y E T A R

